



## VENDIM

*Nr.48 Datë 03.05.2013*

**PËR  
FILLIMIN E PROCEDURAVË PËR MODIFIKIMIN E LICENSËS  
SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË  
“ENERGY PARTNERS-AL” SH.P.K ME NR.118, SERIE PV11K,  
LESHUAR ME VENDIM TE BORDIT TE KOMISIONEREVE TE  
ERE-S NR.07, DT. 02.02.2011**

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikat 2.3 dhe 2.4 të “Liçensës për Prodhimin e Energjisë Elektrike, si dhe nenet 10 dhe 15 pikat 1 dhe 2 germa “b”, pika 4, të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, dhe nenit 18 pika 1, germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin Nr. 21, datë 18.03.2009, të Bordit të Komisionerëve, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 03.05.2013, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “ENERGY PARTNERS-AL” sh.p.k për ndryshimin e liçensës Nr.118, Seria PV11K, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.07, datë 02.02.2011 dhe informacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

### **Konstatoi se:**

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “ENERGY PARTNERS-AL” sh.p.k plotëson kërkesat e “Rregullores së procedurave të liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, si më poshtë:

- ***Neni 15, pika 4, germa “a”:***

Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e liçensës. (është plotësuar tërësisht)

- ***Neni 15, pika 4, germa “b”:***

Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të liçensuarit te cilat shprehin vullnetin për te kërkuar modifikim liçense. (është plotësuar tërësisht)

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurat për modifikimin e liçensës së shoqërisë “Energy Partners-AL”sh.p.k me numër Nr.118, seri PV11K, për Prodhimin e Energjisë Elektrike, lëshuar me Vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.07, dt. 02.02.2011.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Sokol RAMADANI**

**Ne mungese dhe me porosi**

**Entela SHEHAJ**